

Zhvillimi & Tranzicioni 5



www.ks.undp.org

Efektet e krizës globale financiare në Kosovë dhe rajon

*Osnat Lubrani
Përfaqësues Rezident i UNDP-së*

Edicioni i pestë i buletinit elektronik rajonal Zhvillimi dhe Tranzicioni i përgatitur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) me London School of Economics (LSE), përqendrohet në efektet e krizës globale financiare në ekonominë e Kosovës dhe të rajonit. Buletini përbëhet nga artikuj të shkruar nga ekspertët nga Kosova dhe Evropa, të cilët analizojnë perceptimet, implikimet dhe politikat e ndërmarra për t'iu përgjigjur krizës globale financiare. Artikujt japin një mori rekomandimesh të cilat mund të shërbejnë për të reflektuar rreth veprimeve të qeverisë për të parandaluar apo zbutur ndikimin negativ të krizës globale financiare në ekonominë e brishtë të Kosovës. Shpresohet se këto perceptime dhe analiza do të promovojnë një debat si dhe t'i kontribuojnë njohurisë për hartimin e politikave strategjike për t'iu përgjigjur krizave komplekse të cilat kanë ndikim në sektorë të ndryshëm.

Në tërë botën, lidhja në mes të globalizimit dhe integritimit më të madh ekonomik, përveç përfitimeve, po ashtu ka shtuar edhe ekspozimin ndaj rrezikshmërisë, kështu që si rezultat i kësaj dështimi ekonomik në një vend mund të prek shumë shpejt ekonominë tjetra kombëtare. Shembulli më i dalluar është ai që jemi duke përjetuar sot, pra kriza e cila i ka filltet e saj në sistemin bankar amerikan dhe shumë shpejt u shndërrua në recesionin më të thellë në historinë bashkëkohore të SHBA-ve dhe përfundoi në krizë globale ekonomike dhe financiare. Shkalla e papunësisë sot është më e larta në tridhjetë vitet e fundit, bursat kanë filluar të shënojnë rënie, ndërsa rënia e shpejtë e kërkesës së konsumatorëve ka bërë që ekonomia të fillojë të çalojë dhe ka kthyer mbrapshtë trendet pozitive të rritjes ekonomike në shumë vende. Pako të ndryshme të ndihmave financiare në shumë prej miliarda euro janë futur në funksion nga

shumë vende, si një masë emergjence për të parandaluar përhapjen e krizës në shumë ekonomi kombëtare.

Përderisa argumentohet se kriza globale financiare nuk ka goditur Kosovën drejtpërdrejtë, ekonomia e saj ka ndjerë efektet e saj indirekte. Vendet donatore kanë hezitur të rrisin ndihmën e tyre për Kosovën për shkak të problemeve të brendshme; rritja dramatike e papunësisë si në Evropë ashtu edhe në SHBA, ka prekur diasporën kosovare. Rënia pasuese e dërgesave nga kosovarët të cilët punojnë jashtë vendit ka mundësi të ketë ndikim negativ në ekonominë e Kosovës në përgjithësi.

Ky edicion i buletinit Zhvillimi dhe Tranzicioni ofron një përmbledhje gjithëpërfshirëse të implikimeve financiare të krizës globale financiare për rajonin dhe sipërfaqësisht për Kosovën. Buletini thekson sfidat kritike me të cilat Kosova ka mundësi të ballafaqohet dhe ofron perceptime për masat me potencial për tejkalimin e tyre.

Dëshiroj të shpreh falënderimet e mia autorëve për kontributin e tyre. Për më tepër inkurajoj lexuesit të shfrytëzojnë këtë buletin dhe të stimulojnë një debat konstruktiv rreth krizës dhe masave të cilat duhet të ndërmerren për të tejkaluar atë.

Shënim:

Që nga viti 2006 Zhvillimi dhe Tranzicioni është përgatitur nga UNDP-ja në bashkëpunim me LSE-në. Katër edicionet e para kanë qenë të përqendruara në varfëri dhe zhvillim, konflikt dhe zhvillim, zhvillimin e sektorit privat, dhe në sigurinë e ushqimit dhe zhvillim rural. Buletini ka për qëllim promovimin e debateve të orientuara kah politikat, në mesin e partnerëve të UNDP-së dhe palëve të interesuara, në çështjet kryesore dhe pyetjet në lidhje me sfidat zhvillimore me të cilat ballafaqohet Kosova. Buletini i jep një theks të veçantë zhvillimit njerëzor, zbutjes së papunësisë, Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit, dhe Strategjive për zbutjen e papunësisë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin nuk janë domosdoshmërisht të UNDP-së; më tepër, qëllimi i buletinit është të inkurajojë debatin e hapur për çështjet që UNDP-ja i konsideron të rëndësishme.

Artikujt për Zhvillimi dhe Tranzicion

1. Perceptimi publik dhe sektori bankar në Kosovë / Levent Koro	2
2. Presionet fiskale që janë duke u shfaqur dhe politika makroekonomike e Kosovës / Besnik Hyseni	4
3. Kriza financiare globale dhe sektori bankar i Kosovës / Valentin Toçi and Arben Mustafa	6
4. Përgjigjja ndaj rënies së remitancave (dërgesave të parave nga diaspora) dhe ndaj kthimit të emigrantëve / Nick Maddock and Lovita Ramguttee	8
5. Tranzicioni pas krizës / Saul Estrin	11
6. Implikimet e krizës globale financiare për Evropën Lindore / Anders Åslund	14
7. Përgjigjja ndaj krizës: thelbi dhe periferia / Marek Dabrowski	17

Perceptimi publik dhe sektori bankar në Kosovë

Levent Koro
Ekonomist

Ndërsa vëzhguesit nuk pajtohen për rëndësinë relative të faktorëve të ndryshëm kontribuues, është pranuar në përgjithësi se krizat formojnë një kombinim të zbalancimeve të paqëndrueshme globale makroekonomike, politika monetare të shthurura dhe dobësi strukturore në sistemin financiar. Kriza filloi në vendet e zhvilluara (në mënyrë specifike në tregun dytësor të hipotekës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe pastaj u përhap në vendet në zhvillim përmes një varg kanalesh.

Në shumë vende në zhvillim, kriza është manifestuar kryesisht përmes kushteve të tregtisë dhe lidhjeve në investimeve, duke përfshirë edhe rënien në çmimet e mallrave, eksporteve, remitancave dhe investimeve të huaja direkte.

Ndërsa kanalet e përhapjes ndryshojnë shumë përgjatë vendeve në zhvillim, sektori bankar ishte gjithashtu një nga sektorët e rëndësishëm të prekur nga kriza e sidomos për ato vende në zhvillim që kanë sistemet financiare të integruara me tregjet ndërkombëtare. Ulja në disponueshmërinë e kredive të huaja dhe përkeqësimi i perspektivës në tregjet globale dhe lokale çuan në shtrëngimin e kushteve të kredisë, në ulje të ritmit në kredi, në normat e rritjes së depozitave dhe norma interesi më të larta, si dhe përhapje në shumë vende në zhvillim.

Nga ana tjetër, sektori bankar në Kosovë është perceptuar se nuk do të preket nga kriza globale. Sektori bankar në Kosovë nuk është ekspozuar huamarrjes së jashtme dhe për këtë arsye nuk u prit se do të vuaj nga rrjedhat dalëse financiare. Baza e saj e kreditit është tërësisht e varur mbi depozitat e mbledhura nga tregu vendas. Ekonomia e Kosovës ndryshe nga shumë vende në zhvillim nuk pritet që të vuaj nga ulja e eksporteve dhe kushtet e tregtisë për shkak të bazës së ulët të eksportit që përkeqësoi perspektivën për shumë vende në zhvillim dhe bëri shumë banka më të kujdesshme rreth kreditimeve të reja.

Në shumë raste kemi dëgjuar edhe deklaratat nga qeveria dhe zyrtarët e Bankës Qendrore se sistemi bankar në Kosovë është i matur (i kujdesshëm) prandaj nuk do të preket nga kriza pasi nuk është integruar me tregjet ndërkombëtare financiare.

Perceptimi publik për sektorin bankar në Kosovë

Çfarë është perceptimi publik për qëndrueshmërinë e sistemit bankar? Perceptimi publik është shumë i rëndësishëm sepse (pa marrë parasysh çfarë është gjendja e vërtetë) mund të ndikojë në të vërtetë mbi treguesit e rëndësishëm të sistemit bankar siç është niveli i depozitave

dhe si depozitat mund të ndikojnë në nivelin e kredive të ofruara nga sistemi bankar.

Nga ana tjetër, performanca e sistemit bankar ndikon drejtpërdrejtë në ecurinë e ekonomisë. Kosova ka përjetuar norma të forta të rritjes së kredisë gjatë dy viteve¹ të fundit dhe kreditë në rritje kanë ushqyer në fakt kërkesën e brendshme (konsumin dhe investimet) dhe kanë kontribuar dukshëm në normat e forta të rritjes ekonomike gjatë këtyre viteve². Çdo ndërprerje e këtij trendi do të ndikojë negativisht në ecurinë e rritjes së ekonomisë.

Ky sondazh i opinionit nga Raporti i Paralajmërimit të Hershëm (RPH) ka shikuar më afër perceptimet publike për sektorin bankar. Nga rezultatet e sondazhit duket se publiku nuk është plotësisht i bindur në lidhje me qëndrueshmërinë e sistemit bankar ose së paku deklaratat nga zyrtarët e qeverisë qendrore ose nga banka nuk kanë arritur te publiku i gjerë. Sipas rezultateve të sondazhit rreth 11,7% e të anketuarve nuk i besojnë bankave që veprojnë në Kosovë dhe rreth 17% e të intervistuarve janë të pavendosur nëse do t'i besojnë apo jo bankave që veprojnë në Kosovë.

Tabela 1. A i besoni bankave që veprojnë në Kosovë?

Kombësia				
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Po	76.3%	7.1%	69.6%	71.71%
Jo	10.0%	35.4%	11.6%	11.64%
Nuk di	10.5%	54.0%	17.0%	13.50%
Pa përgjigje	3.2%	3.5%	1.8%	3.15%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.00%

Burimi: Sondazhi i opinionit nga Raporti i Paralajmërimit të Hershëm (RPH)

Në pyetjen se a mendoni se paratë tuaja në bankat në Kosovë janë të sigurta, përsëri rreth 10% e të anketuarve nuk mendojnë se janë të sigurta, një grup shumë më i madh i të anketuarve (rreth 37%) nuk e dinë nëse paratë e tyre janë të sigurta ose jo nëpër bankat që veprojnë në Kosovë.

Tabela 2. A mendoni se paratë tuaja nëpër bankat e Kosovës janë të sigurta?

Kombësia				
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Po	68.1%	6.2%	50.4%	63.32%
Jo	9.2%	30.5%	10.7%	10.54%
Nuk di	19.2%	61.1%	37.1%	22.75%
Pa përgjigje	3.6%	2.2%	1.8%	3.38%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.00%

Burimi: Sondazhi i opinionit nga RPH

¹ Kredia vendore u ngrit nga 892 miliona Euro që nga dhjetori i vitit 2007 në 1,183 miliona Euro në dhjetor 2008 me rritje vjetore prej 32.6%

² Në periudhën 2005-2008, BPV u ngrit në normë mesatare vjetore prej mbi 4%, që u ngrit në 5.4% në vitin 2008.

Çfarë është edhe më brengosëse është se rreth 19% e të anketuarve mendonin për të tërhequr kursimet e tyre nga bankat në shtëpi gjatë gjashtë muajve të fundit dhe 8% e të anketuarve ishin të pavendosur në lidhje me tërheqjen apo jo të kursimeve të tyre nga bankat që vepronin në Kosovë.


Tabela 3. A keni menduar për të zhvendosur paratë nga banka në shtëpi gjatë gjashtë muajve të kaluar?

Kombësia				
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Po	18.5%	10.2%	19.1%	18.08%
Jo	69.4%	70.2%	70.0%	69.45%
Nuk di	5.8%	19.1%	8.2%	6.78%
Pa përgjigje	6.3%	.5%	2.7%	5.69%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.00%

Burimi: Sondazhi i opinionit nga RPH

Bazuar në statistikat e Bankës Qendrore (figura 1), shkalla e rritjes së depozitave gjatë muajve të fundit në të vërtetë ka rënë, edhe pse ka vazhduar një trend pozitiv i rritjes. Nga figura 1 shohim disa ndërprerje në vëllimin e kursimeve të depozituara në bankat komerciale madje edhe në normat negative të rritjes (tërheqje më të lartë sesa kursimet e depozituara) në nëntor 2008 dhe janar 2009. Në mes të prillit 2009 dhe shtatorit 2008 (pika kulmore në vëllimin e depozitave para ndërprerjes) shkalla e rritjes së depozitave ishte vetëm rreth 4% ndërsa norma e rritjes së depozitave midis prillit 2008 dhe shtatorit 2007 ishte rreth 12,5%.

Figura 1: Vëllimi total i depozitave në bankat komerciale




Burimi: Buletini statistikor mujor, Banka Qendrore e Kosovës

Ne gjithashtu shohim disa ndërprerje në normat e kreditimit, edhe pse shkalla e rritjes së kredive ishte shumë më e fortë në krahasim me normat e rritjes së depozitave pasi që bankat komerciale vazhduan t'i shërbejnë klientëve (mbi normën e rritjes së depozitave) duke ulur kërkesat e tyre rez-

ervë. Në mes të prillit 2009 dhe shtatorit 2008, norma e rritjes së kredive të lëshuara nga bankat komerciale ishte rreth 9,6% ndërsa norma e rritjes së kredive në mes prillit 2008 dhe shtatorit 2007 ishte rreth 23,5%. Megjithatë, në qoftë se depozitat vazhdojnë të rriten dalëngadalë, normat e rritjes së kredisë në mënyrë të pashmangshme do të ngadalësojnë dhe do të ndjekin rrugën e rritjes së depozitave.

Figura 2: Vëllimi total i kredive të lëshuara nga bankat komerciale



Burimi: Buletini statistikor mujor, Banka Qendrore e Kosovës

Rekomandimet politike :

Qeveria e Kosovës dhe Banka Qendrore duhet të konsiderojnë alternativat politike në drejtim të forcimit të perceptimeve për sistemin bankar dhe duhet të shmangin ndërmarrjen e veprimeve që do të dëmtojnë perceptimet publike. Një alternativë e politikës mund të jetë paraqitja e skemës së sigurimit të depozitave. Paraqitja e skemës së sigurimit të depozitave do të jetë shumë e dobishme për forcimin e besimit dhe perceptimit të publikut në sistemin bankar dhe për të ruajtur nivelet e rritjes së depozitave dhe të kredive në sistemin bankar. Paraqitja e skemës së sigurimit të depozitave me gjasë do të paraqesë barrë të rëndë mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen financiare dhe Banka Qendrore e Kosovës kërkon ndërtimin e këtyre kapaciteteve për të kryer punën në mënyrë adekuate.

Së dyti, raporti i fundit i FMN-së thekson përqendrimin e bilancit fiskal (nga bilanci fiskal në vitin 2008 deri te deficieti i buxhetit prej 8% të Bruto Produktit Vendor në vitin 2009) dhe qëllimin e Qeverisë për përdorimin e depozitave të PTK-së nga sistemi bankar për financimin e deficitit. Tërheqja e depozitave të PTK-së për të financuar deficitet e buxhetit mund të përqendrojë më tej perceptimet publike për bazën e sistemit bankar dhe do të ketë ndikim të dëmshëm mbi normat e rritjes së depozitave. Qeveria e Kosovës duhet të shmangë këtë alternativë, ose të paktën duhet të konsiderojë kompensimin e shumës duke sjellë fondet e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës nga tregjet ndërkombëtare në sistemin bankar të vendit.

Presionet fiskale që janë duke u shfaqur dhe politika makroekonomike e Kosovës


Besnik Hyseni
Ekonomist

Shpallja e pavarësisë së Kosovës erdhi pak kohë para fillimit të krizës globale ekonomike. Vendimi shtoi presione të reja fiskale për qeverinë në kohën kur perspektiva për investime më të mëdha direkte dhe për eksporte ishin duke rënë. Kjo la ekonominë e saj të re të varur në shpenzimet publike për të zbutur në mënyrë indirekte efektet e rënies dhe për të ruajtur një shkallë të moderuar të rritjes ekonomike. Suficiti buxhetor që ka akumuluar qeveria e Kosovës në të kaluarën për shkak të kapacitetit të cekët akumulues, joefikasiteti administrativ në mesin e arsyeve tjera, është shfrytëzuar për të rritur shpenzimet kapitale të buxhetit të cilat përfshinë investimet në sektorin e energjisë, transportit, bujqësisë, ndërtimit të shkollave, dhe përmirësime tjera infrastrukturore. Shpenzimet për këto projekte kanë kaluar dyfishin në vitin 2008 përderisa projeksionet për vitin 2009 mbesin të larta, që reflektojnë presionin për përmirësim të sektorëve thelbësor të ekonomisë pasi që Kosova mundohet që të afirmohet si shteti më i ri Evropian. Si shtet i ri, Kosova gjithashtu ka nevoja tjera për shpenzime siç janë konsolidimi i plotë i Ministrisë së punëve të jashtme, përfshirë ambasadat e reja, programet për siguri dhe pakica, etj.

Financimi i disa nga programet e reja të përqendruara pritet që të shtyjë bilancin buxhetor në deficit. Buxheti vjetor ndiqte deficitin në vitin 2008 përderisa deficitin buxhetor i vitit 2009 pritet të arrij rreth 7% të BPV-së. Përkundër recetës nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), qeveria vendosi që të ngritë rrogat e punëtorëve publik për 10% duke filluar nga janari i vitit 2009¹. Përderisa kjo rritje e pagave mund të përmirësojë cilësinë e punës, të nxitë integritetin qeveritar, etj. ajo nuk paralajmëron arritjen e kornizës fiskale të qëndrueshme, në veçanti kur merren parasysh shpenzimet e fundit kapitale dhe problemet me deficitin e lartë kuazi-fiskal të sektorit të energjisë. Qeveria ka ulur shkallën e taksave në fillim të vitit në përpjekje për tu bërë më konkurruese në regjion dhe të promovojë investimet direkte. Tatimi në fitim u ul nga 20% në 10% dhe taksat individuale në të ardhura u ulën nga 10% në 8%, dhe nga 5% në 4%.² Stimulimet më të ulëta për evazion nga taksat mund të përmirësojnë mbledhjen e tyre, sidoqoftë kur kjo politikë e uljes së taksave hyri në fuqi në fillim të vitit 2009, kur opinionin investues ishte tanimë i ulët, efektet e kësaj reforme fiskale për bazën tatimore dhe të hyrat e përgjithshme nuk janë plotësisht

të qarta. Shifrat për të hyrat e projektuara qeveritare sugjerojnë një vakuim substancial financiar në disa vite në vijim me qëllim të përmbushjes së objektivave të rritjes ekonomike me shpenzimet kapitale qeveritare. Ministria e ekonomisë dhe financave ka projektuar një hendek të përgjithshëm financimi prej afro 300 milion Euro (për periudhën 2009-2012)³ me kontribute të donatorëve ose huamarrje të cilat priten që të mbushin këtë hendek.

Figura 1. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore



Burimi: Korniza afatmesme e shpenzimeve e Kosovës 2009

Duke menduar lidhur me pasigurinë e deficitit fiskal dhe shpenzimet e larta të projektuara, është me rëndësi që të kujtohet një nga tiparet më të rëndësishme të ekonomisë kosovare që është Eurozimi – politika fiskale si instrumenti i vetëm për ndërhyrje. Përderisa presionet fiskale të nënvizuara më sipër nuk janë atipike për shumë shtete në tranzicion, nuk janë të gjitha shtetet në zhvillim të kufizuara vetëm në domenin fiskal. Për Kosovën kjo ka disa implikime politike thelbësore.

Përkundërt faktit se efektet e krizës së fundit ekonomike globale ishin minimale në Kosovë, mësimet e rëndësishme për politikën fiskale për t'ju përgjigjur tronditjeve të ardhme ekonomike janë (i) që të përmirësohet cilësia e kursimeve ekzistuese dhe të ulen shpenzimet jo thelbësore për të siguruar aftësinë paguese të qeverisë për mbrojtjen e ekonomisë së mirëfilltë nga tronditjet e ardhme të jashtme (ii) të shtohet rezerva e fondeve stabilizuese minimale për të reflektuar madhësinë e ekonomisë (iii) që të fitojë përfitime politikë-bërëse duke zhvilluar një treg qeveritar të borxhit si instrument alternativ për të siguruar më shumë fleksibilitet për punët e qeverisë.

¹ Raporti i KASH 2009

² Raporti i KASH 2008

³ Raporti i KASH 2009

Euro si monedhë (jo)zyrtare kombëtare i ka siguruar Kosovës shumë fleksibilitet të nevojshëm në sektorin e jashtëm por me shumë kufizime në opsionet e politikës ekonomike në dispozicion për autoritetet Kosovare. Përveç stabilitetit të çmimeve, eurozimi i ka ofruar sektorit financiar një shkallë shtesë të kredibilitetit. Ajo gjithashtu ka eliminuar mundësinë e rënies së bankave dhe për sulmet spekulative ndaj monedhës vendore. Me euro, Kosova ka kaluar rrezikun e mospërshtatjes së monedhave për shlyerjen e borxhit që mundëson fleksibilitet të dobishëm në të ardhmen. Pasojat e mospërshtatjes së monedhave janë ndërjet rëndë gjatë krizës financiare të fundit në ekonomitë me ndikim të madh siç janë Islanda, Hungaria, Letonia, etj. pasi që borxhi i tyre i shprehur në monedhë të huaj u bë tepër i shtrenjtë për tu shlyer. Kohëve të fundit euro ka vepruar për të zbutur rrezikun e sektorit të jashtëm duke mundësuar një shkallë të fleksibilitetit me deficitin e rrezikshëm të lartë aktual të llogarive që tani është duke arritur 28,5% të BPV-së (37.2% pa asistencë të huaj)⁴. Në skena alternative, kjo do të kërkonte nga Banka Qendrore që të ndërhyjë me sasi të mëdha të rezervave të huaja këmbimore për të mbrojtur monedhën dhe për të financuar deficitin.

Sidoqoftë nën aranzhimin aktual si ekonomi me euro, Kosova nuk ka bankë qendrore për të udhëhequr politikën monetare për të absorbuar efektet e tronditjeve të jashtme, që do të thotë caktimi i shkallës nominale të interesit për të stimuluar kërkesën e përgjithshme. Ndikimi nga tronditjet makroekonomike më pas bien mbi ekonominë e mirëfilltë. Pasi që efektet nga kriza e fundit globale ishin minimale për Kosovën, kjo nuk do të thotë se kështu do të jetë gjithmonë, në veçanti pasi që Kosova synon rritjen e hyrjes së kapitalit të huaj dhe të bëhet më e integruar në tregtinë globale.

Alternativë e mençur për këtë mundësi të fleksibilitetit është reduktimi i shpenzimeve jo thelbësore dhe përqendrimi në cilësinë e shpenzimit, ndërtimi i rezervës stabilizuese dhe zhvillimi i tregut qeveritar të letrave me vlerë, në kohë të duhur.

- Qeveria ka një nivel kontrolli mbi mbledhjen e të hyrave dhe politikën e tatimeve, por ndoshta ka kontroll më direkt në kontrollimin e kostove të administratës së saj që është më shumë një mekanizëm i zakonshëm i ndërhyrjes. Orientimi i shpenzimeve qeveritare mbetet një nga fushat më të rëndësishme në sigurimin e bilancit të qëndrueshëm buxhetor për Kosovën. Një nga mënyrat më thelbësore për të reduktuar kos-

tot do të jetë përqendrimi në cilësinë e shpenzimeve dhe për të reduktuar shpenzimet qeveritare jo thelbësore të cilat mund të përfshijnë kostot administrative, koston e udhëtimit dhe ndoshta çka është më e rëndësishme – subvencionet për KEK-un. Përkundrejt planeve aktuale për të ndërprerë subvencionet për KEK-un gjer në vitin 2011, këto subvencione mund të vazhdojnë, në veçanti pasi që nuk kishte paralajmërime për privatizim të KEK-ut.

- Ndërkohë që fondet e stabilizimit mund të duken të privojnë ekonominë nga investimet shtesë, ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zbutjen e efekteve gjatë emergjencave financiare dhe sigurojnë kredibilitetin e mëtejshëm për sektorin financiar. Tashmë është një fond i stabilizimit i grumbulluar kohët e fundit prej rreth 200 milion euro i cili mbahet në Bankën Qendrore që ofron një siguri për likuiditetin në rast të një emergjence financiare. Fondi ende mbetet në rreth 4% të BPV-së duke u përpjekur për të arritur shumën e rekomanduar nga FMN-ja, por është një hap i rëndësishëm duke njohur rëndësinë e rolit të fondeve të stabilizimit.
- Me qëllim të menaxhimit më efektiv të buxhetit të saj qeveritar dhe për t'i dhënë më shumë fleksibilitet instrumentit të saj të vetëm të vërtetë politikëbërës, Kosova duhet të fillojë zhvillimin e një tregu të borxhit të qeverisë. Letrat me vlerë nga Qeveria kanë potencial për t'i ofruar qeverisë qasje të lirë në financa pasi që, për dallim nga kreditë e zakonshme, letrat me vlerë mund të këmbehen në tregun sekondar. Në afat të gjatë, ky instrument mund të përdoret për të menaxhuar borxhin publik me efikasitet. Gjithashtu, për shkak të mungesës së rrezikut për monedhën dhe rrezikut të inflacionit, qeveria e letrave me vlerë me valutë euro do të ketë kredibilitet të mjaftueshëm për investitorët.

Deri tani ka një konsensus se efektet e krizës globale ekonomike në Kosovë kanë qenë modeste në rastin më të mirë. Megjithatë, pasi që Kosova kërkon më tej integrimin ekonomik, ajo nuk mund të mbetet e mbrojtur prej tronditjeve në të ardhmen, prandaj do të duhet të zhvillojë një politikë largpamëse të menaxhimit fiskal. Çfarë del si një implikim i rëndësishëm për Kosovën është se politika fiskale, si instrument i vetëm kur ka edhe presione të mëdha për shpenzime që tendosin financat e qeverisë, mund të jetë e rrezikshme sidomos kur deficitet financiare në rritje bëhen më të vështira.

⁴ Raporti i KASH 2009

Kriza financiare globale dhe sektori bankar i Kosovës

Valentin Toçi, PhD
Kryeekonomist i BQK-së

Arben Mustafa, MSc
Drejtor i Drejtorisë për Analiza Ekonomike të BQK-së

Ekonomia botërore po vazhdon të ballafaqohet me një rëndësi të madhe në historinë e krizës financiare. Pasojat e krizës financiare u reflektuan edhe në sektorin real të ekonomisë, duke shkaktuar po ashtu një rëndësi të madhe ekonomike globale. Në këtë drejtim, qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve të zhvilluara ishin aktive në ndërmarrjen e masave për të stimuluar aktivitetin ekonomik në vendet e tyre dhe kohët e fundit jemi dëshmitarë të shenjave të para të një rikuperimi ekonomik në disa ekonomitë. Në sektorin financiar të Kosovës, efekti i krizës ishte modest, i karakterizuar me një ngadalësim të kredidhënies nga ana e bankave, përderisa niveli i qëndrueshmërisë së sektorit u ruajt, me gjithë rrethanat e pafavorshme në sektorin financiar ndërkombëtar. Megjithatë, në Kosovë, ndikimet e krizës ishin më të theksuara në sektorin real të ekonomisë ku po vërehet një ngadalësim i aktivitetit ekonomik.

Kriza financiare globale

Shenjat e para të evolimit të krizës financiare u shfaqën në sektorin financiar të SHBA-së në vitin 2007, më konkretisht në tregun e kredive hipotekare, për t'u shpërndarë brenda një periudhe të shkurtër edhe në sektorët financiarë të vendeve të tjera të zhvilluara. Rritja e lëvizjes së kapitalit nga shtetet e tjera drejtë SHBA-së si dhe liberalizimi i sistemit financiar krijuan kushte më të volitshme për rritjen e shkallës së ndërmjetësimit financiar në këtë vend. Kjo ndikoi në rritjen e shpejtë të konkurrencës në këtë sektor që u manifestua me një sjellje më agresive të bankave të cilat, në përpjekje për të rritur pjesëmarrjen e tyre në treg, dështuan në menaxhimin e riskut, gjë që rezultoi në përqendrim të portofolive të tyre. Lehtësimi i kriterëve të kreditimit nga ana e bankave u shoqërua edhe me rënie të konsiderueshme të normave të interesit me çka u shkaktua një rritje e shpejtë e kërkesës për kredi e posaçërisht për ato hipotekare. Rritja e kredive hipotekare u reflektua në një rritje të shpejtë të kërkesës në tregun e shtëpive, çka shkaktoi normë të lartë të rritjes së nivelit të çmimeve në këtë treg.

Presionet inflacioniste të cilat filluan të shfaqen në SHBA, shtynë FED-in të rritë normën bazë të interesit, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e kërkesës për kredi. Efektet nga zvogëlimi i kredisë u reflektuan edhe në tregun e shtëpive ku u paraqit rënie e ndjeshme e kërkesës, me çka edhe filloi trendi i rënies së çmimeve të shtëpive. Po ashtu, ngritja e normave të interesit shkaktoi vështirësi te kredimarrësit, posaçërisht te ata me rangim më të ulët kreditor, për të paguar kreditë dhe, si pasojë, një numër i madh i kredive hipotekare dështoi për

t'u paguar. Kjo shkaktoi nxjerrjen në shitje të një numri të madh të shtëpive dhe u reflektua në rënie të mëtutjeshme të çmimeve në këtë treg. Rënia e vazhdueshme e çmimeve të shtëpive stimuloi dështimin e mëtejshëm të kredive hipotekare. E tërë kjo ndikoi në përqendrimin e vazhdueshëm të cilësisë së portofolit kreditor të bankave duke shkaktuar humbje të mëdha të një numri i konsiderueshëm i tyre.

Niveli i lartë i ndërlidhjes brenda institucioneve financiare në SHBA si dhe shkalla e lartë e integritimit ndërkombëtar të sistemeve financiare bënë që problemet financiare të përhapen shpejtë në tërë globin, me theks më të madh në vendet e zhvilluara. Këto zhvillime shkaktuan vështirësi serioze të institucioneve financiare duke çuar në bankrotim një numër të institucioneve mjaft të mirënjohura në sistemin financiar ndërkombëtar. Si pasojë, besimi ndërmjet institucioneve financiare zbriti në nivelin më të ulët duke shkaktuar një formë të shembjes së tregut ndërbankar. Me këtë, problemet e sistemit financiar vazhduan të rriten si pasojë e qasjes së vështirësuar në mjete likuide. Megjithatë, ishte i shpejtë reagimi i qeverive dhe bankave qendrore të cilat vepruan për të sanuar situatën e krijuar. Ndër masat e para dhe më të rëndësishme ishte ulja e vazhdueshme e normës bazë të interesit nga bankat qendrore, me çka u arrit plotësimi i nevojave të likuiditetit në treg. Për shembull, Banka Qendrore Evropiane zvogëloi normat e interesit prej mbi katër për qind në një për qind, duke çuar në një rënie të konsiderueshme të normës së EURIBOR-it. Me gjithë mjaftueshmërinë dhe koston e ulët të mjeteve likuide në treg, aktiviteti në tregun ndërbankar vazhdon të jetë i ulët si rezultat i mungesës së besimit ndërmjet institucioneve bankare. Me qëllim të nxitjes së shkëmbimit ndërbankar janë prezantuar skema të ndryshme të garancioneve bankare, të destinuara për kthimin e besimit në këtë treg, i cili ka rëndësi të madhe për funksionimin e mirëfillt të sistemit financiar.

Problemet e krijuara në sektorin financiar u reflektuan negativisht edhe në sektorin real të ekonomisë duke shkaktuar po ashtu edhe krizën më të madhe ekonomike që nga depresioni i madh i viteve të tridhjeta. Humbjet e mëdha të cilat u regjistruan nga bankat komerciale shkaktuan shtrëngim të ndjeshëm të kredisë drejtë sektorit real të ekonomisë, çka shkaktoi rënie të investimeve dhe humbjen e besimit në tregje, manifestuar më rënie të thellë të çmimeve të aksioneve në bursat ndërkombëtare. Si pasojë, një numër i madh i korporatave të njohura ndërkombëtare u gjenden para falimentimit. Efektet e krizës ekonomike u përhapen shpejtë në tërë globin, duke u karakterizuar kryesisht me rënie të kërkesës së brendshme, nivel më të ulët të eksporteve si dhe shkurtim të konsiderueshëm të vendeve të punës. Megjithatë, jo të gjitha ekonomitë u ndikuan në masë të njëjtë nga kriza ekonomike. Në vendet me strukturë më të thjeshtë të ekonomisë, siç është edhe Kosova ku aktiviteti ekonomik bazohet kryesisht në tregti, efektet e krizës, së paku deri në këtë fazë, ishin më të kufizuara.

Sektori bankar i Kosovës

Sektori bankar i Kosovës është një sektor relativisht i ri i cili filloi të funksionojë në vitin 1999, përderisa para kësaj kohe në

Kosovë nuk kishte sistem bankar modern në kuptimin e ofrimit të ndërmjetësimit financiar bazuar në kushtet e ekonomisë së tregut. Si vendi i fundit në rajon që ka filluar procesin e tranzicionit, Kosova po vazhdon të kalojë nëpër sfida të shumta të rimëkëmbjes ekonomike dhe konsolidimit të institucioneve për të krijuar kushtet për funksionimin e ekonomisë së tregut. Përkundër reputacionit jo të mirë të trashëguar nga periudha e ish-Jugosllavisë, kur klientët Kosovar humbën kursimet e tyre, sektori bankar në Kosovë ka rikthyer besimin, duke bërë këtë industri të radhitet në mesin e tregimeve më të suksesshme të ekonomisë së Kosovës që nga përfundimi i luftës. Këtu rol të rëndësishëm ka luajtur BQK, e cila në rolin e rregullatorit të sistemit financiar, i ka prirë zhvillimit të këtij sektori si dhe prezenca e bankave të huaja të cilat sollën reputacionin nga vendet prej nga vinin dhe vendosën bazat e bankingut modern në Kosovë. Sistemi bankar i Kosovës karakterizohet me një pjesëmarrje të lartë të bankave të huaja të cilat përbëjnë rreth 90 përqind të gjithë asetëve të këtij sektori. Prezenca e bankave me origjinë nga vendet me sektorë të avancuar financiar ka qenë faktor shtytës në adaptimin e praktikave më bashkohore të veprimtarisë bankare në Kosovë, me theks të posaçëm në lancimin e vazhdueshëm të produkteve të reja bankare si dhe praktikave moderne për vlerësimin e rrezikut.

Struktura e tregut në sistemin bankar të Kosovës karakterizohet me shkallë të lartë të koncentrimin. Sidoqoftë, trendet e fundit tregojnë për rënie të shkallës së koncentrimin në këtë treg, si rezultat i hyrjes së bankave të reja dhe konsolidimit të tregut, me një kontribut të theksuar në rritjen e shkallës së konkurrencës në këtë sektor. Si rezultat, vazhdimisht është vërejtur rënie e kostos së ndërmjetësimit financiar, numër më i madh i produkteve bankare, zgjerim i rrjetit të bankave dhe lehtësimi i qasjes së klientëve në shërbimet bankare. Sektori bankar i Kosovës, duke adaptuar vazhdimisht teknologji të re, po zhvillohet konform trendeve të bankingut modern duke i'u përshtatur ndryshimit të sjelljes së konsumatorëve në drejtim të shërbimeve bankare.

Sektori bankar paraqet po ashtu njërin ndër faktorët kyç në stimulimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Kreditë aktive të sektorit bankar kanë arritur në rreth 1.3 miliard euro që paraqet mbi 30 përqind të PBB-së së vendit. Financimi i kredidhënies nga bankat komerciale në masën më të madhe financohet nga depozitat e mbledhura përbrenda Kosovës të cilat kanë arritur në rreth 1.5 miliard euro.

Me gjithë përmirësimet e vazhdueshme, kostoja e ndërmjetësimit në sistemin bankar vazhdon të konsiderohet e lartë. Në këtë kanë ndikuar faktorë të ndryshëm të ndërlidhur si me vetë bankat ashtu edhe me rrethinën afariste. Për shembull, normat e larta të interesit mund t'i atribuohen shpenzimeve të larta operacionale çka nënkupton nevojën për ngritje të efikasitetit në banka. Pastaj, historia e shkurtër kreditore e kredimarrësve, e cila buron nga periudha e shkurtër e funksionimit të sistemit bankar, paraqet vështirësi për matjen e rrezikut kreditor, gjë që ndikon në perceptim më të lartë të rrezikut kreditor dhe normë më të lartë të interesit në kredi. Ndër faktorët që do të mund të ndikonin në uljen e nivelit të perceptuar të rrezikut kreditor, rrjedhimisht

në normat e interesit në kredi, dhe nivelin e ndërmjetësimit janë zbatimi i mirëfilltë i ligjit mbi raportimin financiar të bizneseve, arsyeshmëria e projekteve investuese si dhe ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor që do të lehtësonte ekzekutimin e kolateralit të kreditit e humbura.

Sistemi bankar i Kosovës gjatë gjithë periudhës së funksionimit ka qenë i karakterizuar me nivel të lartë të qëndrueshmërisë që ka buruar nga aplikimi i politikave konzervative të kreditimit nga ana e bankave dhe mbikëqyrja konzervative nga rregullatori. Kjo shpjegohet edhe me faktin se pjesëmarrja e kredive të këqija në gjithësej portofolin kreditor të sektorit bankar është në nivel të ulët dhe e radhitë sektorin bankar të Kosovës ndër sektorët me cilësinë më të mirë të portofolit kreditor në rajon.

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të ketë nivel të lartë të stabilitetit edhe përkundër zhvillimeve negative në sektorin financiar ndërkombëtar si rezultat i krizës financiare. Kësaj gjendje i ka kontribuar edhe jokompleksiteti i vet sektorit bankar të Kosovës. Me gjithë avancimin e vazhdueshëm, funksioni i bankave komerciale që operojnë në Kosovë vazhdon të jetë bazik, kryesisht i koncentruar në kreditimin e ekonomisë vendore, duke u financuar nga depozitat e mbledhura brenda vendit. Kjo ka bërë që bankat komerciale të cilat operojnë në Kosovë të mos kenë nivel të lartë të ekspozimit ndaj sektorit të jashtëm, ndërsa financimi përmes depozitave të mbledhura brenda vendit ka bërë që niveli i kreditimit në Kosovë të mos jetë i varur nga oferta dhe kostoja e fondeve në sektorin e jashtëm.

Për kundër faktit që si kreditë ashtu edhe depozitat kanë treguar norma pozitive të rritjes gjatë tërë periudhës, trendet e fundit tregojnë për ngadalësim të këtyre normave, posaçërisht të kreditit, gjë që mund të interpretohet si kujdes i shtuar i bankave në rrethanat e reja që janë krijuar si pasojë e shtrirjes së krizës ekonomike globale. Duke marrë parasysh zhvillimet e deritanishme, mund të konsiderohet që sektori bankar i Kosovës është treguar imun ndaj krizës financiare globale. Megjithatë, si rrjedhojë e shtrirjes së vazhdueshme të krizës ekonomike, pritet një ngadalësim i aktivitetit ekonomik edhe në Kosovë, me implikime të mundshme negative edhe për performancën e sektorit bankar.

Rritja e normës së papunësisë në vendet e Evropës perëndimore ka goditur edhe emigrantët Kosovarë, duke zvogëluar kështu nivelin e dërgesave të emigrantëve drejt Kosovës, të cilat paraqesin një ndër burimet kryesore të financimit për ekonominë e vendit. Po ashtu, rënia e kërkesës në sektorin e jashtëm, si rezultat i recesionit, është reflektuar negativisht edhe në nivelin e eksporteve, duke goditur industritë kryesore eksportuese. Nën këto rrethana, shtrëngimi i kredidhënies drejt sektorit real të ekonomisë mund të kontribuojë në thellimin e mëtejme të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në vend. Andaj, vazhdimi i kreditimit edhe në këtë kohë, duke respektuar parimet e kreditimit të shëndoshë, paraqet një faktor shumë të rëndësishëm për të stimuluar aktivitetin ekonomik në vend dhe për të mënjanuar në një masë efektet negative nga kriza.

Shënim: Qëndrimet e shprehura në këtë artikull paraqesin pikëpamjet e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pikëpamjet e BQK-së.

Përgjigjja ndaj rënies së remitancave (dërgesave të parave nga diaspora) dhe ndaj kthimit të emigrantëve

Nick Maddock dhe Lovita Ramguttee

Vlerësimet e tanishme sugjerojnë që ndërsa në mbarë botën remitancat (dërgesat e parave nga migrimi) do të bien në mes 5 për qind dhe 8 për qind në vitin 2009, Evropa dhe Azia Qendrore janë regjionet që do të preken më së rëndi me një rënie prej në mes 10 për qind dhe rreth 13 për qind¹. Për vendet me varësi të madhe nga dërgesat dhe migrimi, efektet e krizës do të zmadhohen. Migracioni ekonomik dhe dërgesat janë të rëndësishme për shumë vende në tranzicion dhe në të vërtetë në vitin 2006, Takhikistani dhe Moldavia kanë pranuar nivelet më të larta të dërgesave të parave në botë (si përqindje e BPV-së), kurse Kirgistani është në vendin e katërt². Përveç shqyrtimit të disa nga të dhënat e fundit të migrimit dhe remitancave në rajon, ky artikull propozon disa nga reagimet e mundshme të problemeve socio-ekonomike që mund të rezultojnë nga të ardhurat në rënie nga remitancat dhe numri i madh i emigrantëve të kthyer.

Migrimi dhe remitancat në Moldavi

Ekonomia e Moldavisë drejtohet fuqishëm nga remitancat. Numri i Moldavëve që punojnë jashtë vendit u rrit nga rreth 56.000 në vitin 1999 në 340,000 në vitin 2007 (nga një popullatë e cila, në vitin 2007, ishte 3.8 milion)³. Remitancat totale ishin 1.5 miliardë \$ në vitin 2007 (36 për qind të BPV-së të Moldavisë) dhe ishte në rritje në gjysmën e parë të vitit 2008, para të krizës ekonomike.

Migracioni është kryesisht nga viset rurale. Nga emigrantët të cilët në vitin 2006 ishin jashtë vendit, të cilët kanë qenë jashtë vendit kohët e fundit, ose që në atë kohë kanë planifikuar për të migruar, 38 për qind ishin nga Kishinau (kryeqyteti) dhe zonat tjera urbane, ndërsa 62 për qind ishin nga viset rurale apo qytetet e vogla me më pak se 10.000 banorë⁴. Rreth 67 për qind e atyre që ishin jashtë vendit në atë kohë ishin nga viset rurale⁵. Shumë emigrantë janë të rinj, me një moshë me-

satore prej 35 vitesh në vitin 2006 dhe mbi 37 për qind e moshës nën 30 vjeçare. Më tej, prej atyre të cilët në 2006 ishin planifikuar të emigrojnë, mbi 44 për qind janë nën moshën 30 vjeçare.⁶

Afro 52 për qind e Moldavëve jashtë vendit në vitin 2006 kanë punuar në Moskë, me 59 për qind në Rusi përgjithësisht. Italia priti grupin e dytë më të madh të emigrantëve (17 për qind). Numri i emigrantëve nga Moldavia në vendet e CIS (bashkësia e shteteve të pavarura) (kryesisht Rusia) është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, sidomos në industrinë e ndërtimitarisë.

Efektet e kthimit të emigrantëve dhe tronditjet në remitanca

Rëniet e remitancave dhe kthimi i emigrantëve në shkallë të madhe mund të shtojë presionin i cili, edhe në kontekst të rënies së rëndë ekonomike, nuk është ndjerë, bile as në masën më të vogël në rajon në tërësi. Në praktikë, trendi i remitancave mund të marrë pak kohë për t'u bërë i qartë. Ndërkohë që ka gjasa për presionet në rënie, ka edhe dëshmi se në tërë botën, remitancat kanë tendencë që të jenë elastike dhe të bien më butë sesa që pritet te rënia ekonomike. Kjo është pjesërisht sepse shumat që dërgohen në shtëpi janë shpesh të vogla (zakonisht rreth 5 për qind e të ardhurave) ashtu që pagesat shpeshherë mund të sigurohen edhe kur bien të ardhurat⁷. Më tej, rrjedhat e remitancave dominohen nga pagesat nga emigrantët që kanë emigruar prej shumë kohësh të cilët, për shkak se shpeshherë janë përshtatur mirë në vendin e tyre të migrimit, mund të jenë në pozitë më të mirë për të gjetur burime alternative të të ardhurave në qoftë se humbin punën e tyre.

Përveç kësaj, emigrantët femra që punojnë në profesione të kujdestarisë ndoshta do të jenë më pak të prekura nga rënia ekonomike sesa punëtorët meshkuj në ndërtimtari. Efektet e ndryshimit demografik në Evropën perëndimore dhe në Amerikën e Veriut dhe kostot e larta për kujdesin ndaj të moshuarve do të thotë se kërkesa për emigrantët femra në profesione të kujdestarisë ka të ngjarë të jetë e qëndrueshme bile edhe në rënie ekonomike dhe kështu mund të kontribuojë në elasticitetin e remitancave .

Remitancat megjithatë do të tkurren nëse njerëzit, që kanë humbur punën e tyre, kthehen më pas në shtëpi (edhe pse mund të ketë një rritje afatshkurtër, pasi që ata që kthehen, marrin edhe kursimet në shtëpi). Kthimi i migruesve megjithatë mund të vonohet dhe ata të kthehen gradualisht e jo në një valë të madhe. Kjo është

¹ Migration and Development Brief (Uashington, D.C.: Banka Botërore, 2009). Nr. 9 (23 mars 2009).

² Ratha D., dhe Xu, Z. Migration and Remittances Factbook (Uashington, DC.: Banka Botërore, 2008). www.worldbank.org/prospects/migrationandremittances

³ Përlllogaritjet e numrit të migruesve ndryshojnë dhe Strategjia kombëtare e zhvillimit 2008-2011 tregon se në vitin 2005, ishin 295,000 migrues dhe 310,000 në vitin 2006.

⁴ Remittances in the Republic of Moldova: Patterns, Trends and Effects. (Chisinau: Organizata ndërkombëtare për migrim, 2007). http://www.un.md/key_doc_pub/10M/Remittances_eng.pdf

⁵ Megjithatë ka shenja se para krizës ky trend ka ndryshuar dhe se kishte kalim në migrimin nga viset urbane, ku një pjesë më e

madhe nga Chisinau dhe qytetet provinciale planifikonin që të punonin jashtë vendit. Kjo sugjeron se migruesit e kualifikuar duhet të ndryshonin dhe/ose furnizimi i migruesve nga viset rurale ishte shpenzuar.

⁶ Shih Organizatën ndërkombëtare për migrim (2007), op.cit

⁷ Shih The Economist. 21-27 shkurt 2009, f. 74

pjesërisht për shkak të aderimit të emigrantëve në vendin e migrimit, zakonisht pasi që kostot burokratike dhe kostot fillestare që lidhet me migrim janë të larta. Zotimi i migruesve për të qëndruar mund të forcohet më tej nga kontrollet e reja të imigracionit ku, për shembull Australia, Shtetet e Bashkuara, Spanja, Italia dhe Malajzia të gjitha kohët e fundit janë duke zbatuar rregullore të reja⁸.

Efektet e rënies së remitancave kanë të ngjarë që të ndihen në mbarë vendin, por kur migrimi është kryesisht nga viset rurale (si në Moldavi), duket e mundshme që efektet do të ndihen në shpërpjesëtim. Në këtë rast ekziston perspektiva për rritje të varfërisë rurale. Ky është tashmë shqetësim në Moldavi, pavarësisht performancave të mira të rritjes midis viteve 1999 dhe 2004 që nxori 40 për qind të popullsisë nga varfëria, që paraqet reduktimin më të madh të varfërisë (në përqindje) në Evropën Qendrore dhe në rajonin e Azisë gjatë kësaj periudhe⁹. Megjithatë, rreth 26 për qind e popullsisë Moldave në vitin 2007 mbeti e varfër, ku dy të tretat e të varfërve jetojnë në viset rurale¹⁰. Një përqendrim i ngjashëm i ndikimeve rurale nga kthimi i emigrantëve është i mundshëm, nëse ka kthim në shpërpjesëtim në kthimet në viset rurale. Ky konkluzion duhet, megjithatë, të karakterizohet me dëshminë se emigrantët kanë përdorur remitancat për të blerë pronë¹¹ banimi në viset urbane dhe/ose kthehen në viset urbane për shkak të perspektivave më të mira për punësim.

Gjithashtu është i mundur përkeqësimi disproporcional në papunësinë e të rinjve. Ndërsa papunësia e të rinjve është relativisht e ulët në disa vende, por jo në të gjitha vendet me popullsi të lartë emigrantëve¹², kjo është arri-

tur pjesërisht nëpërmjet eksportimit të punës në formën e emigrantëve. Me zvogëlim të mundësisë së migrimit, të rinjtë do të detyrohen që të mbështeten në tregjet e brendshme të punës në kohën e rënies së kërkesës për punëtorë. Atje ata do të duhet të konkurrojnë me emigrantët e kthyer të cilët mund të kenë aftësi më të mira (pasi që kanë punuar jashtë shtetit) dhe përvojë më të madhe. Me fjalë të tjera, ka gjasa që të krijohet një brez i 'emigrantëve të zhgënjyer' në mesin e të rinjve, në të njëjtën kohë kur konkurrenca është në rritje në tregjet e brendshme të punës. Mundësitë që rezultojnë në trazira sociale janë të dukshme

Efektet e varfërisë rurale mund të përkeqësohen nga tranzicioni në bujqësi i cili në shumë vende në tranzicion ka shërbyer si një rrjetë sigurie¹³ duke siguruar jetesën dhe të ardhurat nga shitja e produkteve të freskëta apo pak të përpunuara. Rrjedha hyrëse e punës në viset rurale tani kërcënon përplasjen me komercializimin bujqësor që është duke e bërë bujqësinë më shumë një biznes sesa një rrjetë sigurie ose mënyrë jetese¹⁴. Në të vërtetë në Moldavi kombinimi i rrjedhës dalëse të punës nga bujqësia në vitet e fundit (me rritjen e lidhur të produktivitetit të punës), normat e ulëta të rritjes bujqësore dhe varfëria rurale në rritje argumentojnë kundër kapacitetit aktual të bujqësisë për të ri-absorbuar punëtorët e pakualifikuar.¹⁵

Përgjigjet e mundshme

Gjasat e efekteve joproporcionale në viset rurale sugjerojnë shënjestrimin gjeografik të përgjigjeve, të cilat mund të jenë afatshkurtra dhe afatmesme. Të mëparshmit kryesisht do të synonin zbutjen e tronditjeve të menjëhershme, ndërsa veprimet afatmesme dhe më afatgjata do të synojnë shmangien e përkeqësimit të mëtejshëm të varfërisë rurale dhe arritjen e rezultateve të përmirësuar nga tregu i punës.

⁸ Migration and Development Brief. (Uashington D.C.: Banka Botërore.) 23 mars 2009

⁹ Ibid. p. 5.

¹⁰ Moldova: Poverty Update. (Uashington D.C.: Banka Botërore, 2006). Raport Nr. 35618-MD. <http://siteresources.worldbank.org/INTMOLDOVA/Resources/MDPovertyUpdateEng.pdf>

¹¹ Shih Organizatën ndërkombëtare për migrim (2007), op.cit.

¹² Vitet e fundit janë përmirësime në perspektivën e punësimit për rininë e Moldavisë. Punësimi i rinisë (në grupmoshën 15-24 vjeçare) ishte duke rënë në 14 për qind në vitin 2007, që është i ulët për nga standardet Evropiane. (Shih Black Sea Labour Market Reviews: Moldova Country Report. (Bruksel: European Training Foundation, janar 2009.)) Kjo normë është e krahasueshme me papunësinë e rinisë në Britani (14.5 për qind në vitin 2006) dhe më e mirë se normat në Francë (22 për qind në vitin 2006) dhe Rumani (afro 20 për qind në vitin 2005). Papunësia afatgjatë e rinisë (do të thotë për 6 muaj ose më gjatë) gjithashtu ka rënë (nga 46 për qind të rinisë së papunë në vitin 2006 në 35 për qind në vitin 2007). Papunësia e rinisë është gjithashtu e ulët në Kazakistan (14 për qind në vitin 2004) dhe Shqipëri (afro 13 për qind në vitin 2005), ashtu që të dyja vendet kanë popullsi të madhe migruese. Ky megjithatë nuk është rasti me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe ish republikën jugosllave të Maqedonisë, ku që të dyja kanë normë të lartë të papunësisë së të rinjve (58 për qind dhe 60 për qind, respektivisht) përkundër popullsisë së madhe migruese. Shih <http://www.indexmundi.com/romania/youth-unemployment-rate.html>

¹³ Davis, J. 'Rural non-farm livelihoods in transition countries: emerging issues and policies'. eJade electronic Journal of Agricultural and Development Economics (2006), vëll. 3, nr. 2, f 180-224. www.nri.org/projects/rnfe/index.html. Shih edhe Csaki, C. dhe Lerman, Z. Agriculture transition revisited: issues of land reform and farm restructuring in East Central Europe and the former USSR. Uashington D.C.: Banka Botërore, 2000).

¹⁴ Davis (2006), op.cit. p.186 dhe tabela 1 (f. 187)

¹⁵ Kjo është vërejtur veçanërisht në Moldavi, duke pasur parasysh përqendrimin e prodhimit në aglomerate bujqësore në shkallë të madhe dhe individualizmin konsekuent të kufizuar të bujqësisë. Fermat e tilla janë shumë më të mekanizuara sesa fermat familjare prandaj kërkojnë më pak punëtorë. Tutje, etika e biznesit të aglomerateve bujqësore argumenton absorbimin e punës në përqindje të ulët të produktivitetit të punës, veçanërisht duke ditur se punëtorët janë punonjës që paguhen. Për dallim, për shkak të madhësisë së fermës, fermat e familjes janë të pak ose fare të mekanizuara dhe punëtorët janë kryesisht anëtarë të familjes që nuk paguhen. Por pjesa e vogël e prodhimit bujqësor dhe zona e vogël e kultivuar do të thotë se kapacitetet e fermave familjare për të absorbuar sasi të konsiderueshme të reja të personave të papunë ka të ngjarë të jetë e ulët.

Përveç kësaj, nga veprimet e furnizimit me punë gjithashtu do të kërkohej që të adresojnë papunësinë e të rinjve.¹⁶

Në afat të shkurtër, sigurimi i rrjetave të përkohshme të sigurisë përmes punëve publike do të ndihmojë mbrojtjen nga kthimi i emigrantëve dhe atyre personave të porsa punësuar brenda vendit. Gjetja e punëve të përshtatshme publike të cilat janë konsistente me aftësitë e pjesëmarrësve shpeshherë ka qenë një problem me masa të tilla në të kaluarën, por ky mund të zbutet kur një pjesë e rëndësishme e emigrantëve të kthyer kanë aftësi të ndërtimit (që duket e mundshme duke ditur rënien në ndërtimtari në rajon)¹⁷. Shpejtësia e përgjigjes mund të rritet duke ndërtuar mbi programet ekzistuese të financuara dhe menaxhuara nga donatorët të cilat tashmë kanë të vendosura strukturat e zbatimit¹⁸.

Në afat të mesëm, rritja e punësimit në ekonominë rurale jashtë fermës ka të ngjarë që të jetë thelbësore. Në të vërtetë, moszhvillimi aktual i këtij sektori në ekonominë në tranzicion ofron mundësi për rritjen dhe thithjen e punës. Ironikisht, qasja e kufizuar në financa në viset rurale para krizës mund të ketë pasur përparësinë e rritjes në ekonominë rurale jashtë fermës më pak të varur nga

¹⁶ Për dallim, gjatë adresimit të varfërisë rurale, nuk propozohet ofrimi i mbështetjes nga UNDP për trajnime profesionale ose për prodhim bujqësor. Mbështetja donatore në këto fusha tanimë është e konsiderueshme dhe argumenton kundër përfshirjes së UNDP-së. Megjithatë shumë nga partnerët zhvillimor janë në proces të rishikimit të programeve të tyre në këtë kontekst dhe në përgjigje ndaj krizës. Si rezultat, fushëveprimi dhe përqendrimi i asistencës zhvillimore për Moldavinë mund të ndryshojë dukshëm gjatë muajve në vijim. Shënime politike që janë duke u hartuar nga Banka Botërore mund të ketë ndikim këtu.

¹⁷ Një dimension i ri i punëve publike është shfaqja e mundësisë për të përshtatur punët publike me brengat mjedisore përmes 'gjelbërimit'. Në këtë kontekst ata mund të adresojnë sfidat e papunësisë dhe njëkohësisht të punojnë në ngritjen e efikasitetit të energjisë nëpër ndërtesa publike dhe të reduktojnë rreziqet nga katastrofat natyrore, përmes aktiviteteve të ndërtimtarisë të ndërlidhura me projektet për zbutje të vërshimeve dhe të thatësisë.

¹⁸ Për shembull në Moldavi ka ndërhyrje nga UNDP në tregjet aktive të punës që mbështesin themelimin e qendrave shoqërore të integritetit dhe formacionet profesionale dhe shërbimet e informimit që mund të ngritën për të përfshirë programet e stazhit (praktikës) për të rinjtë.

kreditë bankare sesa në sektorët tjerë, pasi që ekziston pak ose aspak përvojë për mbështetjen në kredi të lira

Rritja ka të ngjarë që të vjen nga dy burime: ndërmarrjet e vogla në sektorin e shërbimeve në formë të shkallës së vogël, ndërmarrjet me prag të ulët të hyrjes, dhe përpunimi i ushqimit. Por ndërsa ka pasur rritje në industrinë e shërbimeve rurale në shumë vende, agropërpunimi de novo është shfaqur ngadalë. Pra mund të kërkohej mbështetja e mëtejme për zhvillimin e përpunimit të ushqimit. Mjedisi i dobët i investimeve është një kontribuues i madh për performancën e dobët, por përveç kësaj, agropërpunuesit janë në përgjithësi të vegjël dhe, sikurse shumica e firmave të vogla në vendet në tranzicion, ato përballen me kufizimet në sektorin e financave, të menaxhimit, të marketingut, të logjistikës dhe me korrupsion. E rëndësishmja është se ato gjithashtu përballen me problemet e teknologjisë dhe, edhe pse ekziston teknologjia e shkallës së vogël me çmim të arsyeshëm (kryesisht nga furnizuesit kinez dhe indian), përpunuesit e vegjël në rajon rrallëherë kanë mundësi që t'i blejnë ato nga këto burime. Si rezultat, përdorimi i makinerisë së dorës së dytë, që shoqërohen me probleme të besueshmërisë dhe cilësisë, është i përhapur gjerë Luftimi i varfërisë rurale mund të kërkojë ndërhyrje në furnizimin me punë, veçanërisht nëse efektet e krizës ndjehen joproporcionalisht nga të rinjtë. Të rinjtë tashmë përballen me disavantazhet e zakonshme të tregut të punës në mungesë të përvojës dhe mosbesimit nga punëdhënësit. Shumë vende kanë programe që kanë për qëllim ndërmarrësinë rinore, me synim që t'i mundësohet të rinjve të ndjekin karrierat alternative. Plotësimi i kësaj me stazh dhe programe për rikualifikim mund të jetë i nevojshëm nëse dëshirohet parandalimi i rritjes së mprehtë të normave të papunësisë së të rinjve.

Nick Maddock është specialist për politikën e zhvillimit rural për zyrën qendrore regjionale të UNDP-së në Bratislavë. Lovita Ramguttee është asistent i përfaqësuesit të UNDP-së në Moldavi.

Tranzicioni pas krizës

Saul Estrin

Tranzicioni, një proces që është ndjekur për afro 20 vite nga ish ekonomitë socialiste të Evropës qendrore dhe lindore, përfshinë një ndryshim nga sistemi ekonomik i karakterizuar me pronësi publike dhe (zakonisht) planifikim central, në ekonominë në të cilën koordinimi ekonomik i ofrohet firmave private përmes tregjeve. Sistemet socialiste kanë siguruar rritje të ngadalshme, disbalance makroekonomike dhe represion politik, prandaj tranzicioni premtonte rritje të madhe, konsum masiv, integrim me ekonomitë e zhvilluara të perëndimit dhe liri politike. Shumica e këtyre premtimeve janë sjellë në pikëpyetje nga kriza e kredisë së vitit 2008 dhe krizat pasuese ekonomike të cilat kanë gjasa të kenë përfundime më të ashpra në vitin 2009 dhe në shumë ekonomi në tranzicion.

Ky artikull merr parasysh mënyrat në të cilat ngasësit kryesor të tranzicionit, për shembull BE dhe integrimi global i tregtisë, ose investimet e huaja direkte, kanë gjasa që të preken nga recesioni. Tranzicioni mund të shihet si një element në procesin e gjerë të globalizimit, ashtu që analiza jonë gjithashtu peshohet në atë nëse kjo do të ndalohet përkohësisht ose përfundimisht nga rënia ekonomike. Ai gjithashtu merr parasysh më detalisht disa implikime të gjasshme të recesionit për ekonomitë në tranzicion, duke vërejtur se ndikimi ka gjasa që të jetë më serioz në disa vende (siç është Estonia, Hungaria, ose Bullgaria) sesa të tjerat (siç është Polonia, Republika Çeke dhe Rusia). Kjo është pasojë e shtegut të caktuar të tranzicionit që ato zgjedhin, për shembull në lidhje me shpejtësinë e privatizimit, çiltërsinë ndaj investimeve të huaja direkte, dhe shkallën e integritimit me BE, si dhe ndikimi i rëndë në kushtet fillestare, natyrisht reformat e tregut para tranzicionit dhe ndihmat në resurse natyrore. Ai përfundon se konvergjenca në mes të ekonomive të zhvilluara dhe në tranzicion me siguri se do të rifillojë, edhe pse performanca mund të jetë më heterogjene, për shembull në mes të anëtarëve të BE-së dhe ata jashtë BE-së, dhe brenda CIS (bashkësia e shteteve të pavarura) në mes të ekonomive të pasura me resurse dhe atyre të varfra me resurse.

Tranzicioni, globalizimi dhe kriza në kredi

Tranzicioni zakonisht konceptohet në mënyrë evolutive dhe një dimensionale, me pikëpamje të qartë të pikës fillestare dhe përfundimtare si dhe të shtegut. Prandaj programet e tranzicionit kanë tendencë që të përfaqësojnë aplikimin e shpejtë të programit të konsensusit të Uashingtonit për ekonomitë që nuk janë gjithmonë më së paku të zhvilluara, por të cilat kanë disa karakteristika të nën-

zhvillimit: institucionet e dobëta mbështetëse të tregut, nivele të larta të ndërhyrjes nga shteti dhe në rregullime të çmimeve, dhe integrim shumë të kufizuar në tregjet globale të produkteve, shërbimeve ose kapitalit. Por ndryshimet radikale formale, për shembull aranzhimet e pronësisë ose ligjet për të drejtat pronësore nuk kanë kërkuar ndryshime të menjëhershme substanciale në praktikë. Në veçanti ndryshimi dhe krijimi i institucioneve dhe promovimi i ndërmarrjeve efikase private dhe i institucioneve të pavarura financiare është dëshmuar i vështirë, me arritje të matura në dekada, e jo në vite, dhe si rezultat u shfaq një llojlojshmëri e qasjeve politike dhe ekonomike. Siç tregojnë indikatorët e tranzicionit të EBRD-së, suksesi në ndërtimin e ekonomisë së tregut, dhe në performancën kombëtare ekonomike, edhe bile gjatë viteve të shpërthimit, ishte heterogjen, duke qenë i ndikuar nga integrimi në sistemin botëror të tregtisë (do të thotë anëtarësimi në BE); pronësia e resurseve të rëndësishme natyrore, ose parakushtet shumë të favorshme (p.sh. një nivel i liberalizimit para tranzicionit dhe konsensusi i gjerë politik në favor të procesit të reformave).

Disa nga ngasësit e globalizimit dhe të suksesit në tranzicion janë pothuajse të ngjashëm. Për shkak të dallimeve në faktorin e kostove, do të thotë puna, përfitimi mund të rritet nga transferi i prodhimit nga vendet e zhvilluara te vendet në zhvillim, kostot në kuptim të menaxhimit dhe kontrollit, transportit, barrierave tregtare, etj. nuk janë aq të larta. Në të vërtetë këto kosto kanë ra për një numër të arsyeve. Zhvillimet në teknologjitë informative dhe të komunikimit kanë reduktuar kostot e transaksioneve të jashtme, përderisa disa ekonomi në zhvillim kanë filluar të adresojnë ato dobësi në mjedisin e tyre institucional, ligjor dhe politik që ndikon kostot e afarizmit në vendet e tyre. Mjedisi global politik ka qenë dashamirës, duke promovuar ekspansion enorm në tregtinë botërore, investime të huaja direkte dhe nënkontraktim.

Këta ngasës gjithashtu janë shoqëruar me procesin e tranzicionit. Shumë ekonomi në tranzicion nuk ishin saktësisht vende në zhvillim (edhe pse BPV për kokë banori ishte shumë nën nivelet perëndimore) por kishin barrierat e ngjashme të larta për tregti dhe rrjedhë të kapitalit, megjithëqë shpeshherë me nivele më të larta të kapitalit njerëzor.

Tutje, nëse 'distanca' përfaqëson një rrugë për të përshkruar barrierat ndaj tregtisë dhe investimeve të huaja direkte, duke ngritur kostot e transportit dhe kostot e afarizmit në mjedise të panjohura, atëherë rrëzimi i komunizmit zvogëloi 'distancën' për shumë ekonomi në tranzicion, në veçanti ato në kufi me BE-në. Përfundimisht mjedisi i politikave liberale ishte i çmueshëm për shumë ekonomi në tranzicion që i mundësonte ata të riorientojnë modelet e tyre tregtare në ekonomitë e tregut para komunizmit.

Dy ngasësit e parë duket se nuk kanë gjasa të ndryshimit. Ndryshimet teknologjike janë të pakthyeshme dhe ka gjasa që të vazhdojnë përkundër krizës së kreditit, dhe përderisa performanca ka qenë heterogjene, drejtimi i përgjithshëm në së paku ekonomitë më të avancuara në tranzicion ka qenë për paraqitjen e reformave institucionale. Përderisa është herët që të vlerësohet ndikimi i krizës së kreditit mbi mjedisin politik, toni i debatit ndërkombëtar sugjeron se mësimet e viteve 1930-ta janë mësuar. Në çdo rast, për vendet në tranzicion që janë anëtarësuar në BE, Brukseli është boshti i mjedisit politik.


Konvergjencë or divergjencë?

Mundësia e ekonomisë për të parashikuar stuhinë varret nga gjendja e saj në kohën kur ka filluar turbulenca, politikat e miratuara si përgjigje, dhe sa gjatë vazhdon turbulenca. Komunizmi kolapsoi pjesërisht sepse nuk mund të siguronte rritje në standardet jetësore në krahasim me ekonomitë e zhvilluara, dhe tranzicioni do të gjykohej kryesisht me atë nëse ia ka arritur që të kthejë mbrapsht atë divergjencë në BPV-në për kokë banori. Ne konsiderojmë se të dhënat në grafikët 1-4 të cilat tregojnë nivelin e BPV-së për kokë banori (në kuptim të blerjes-fuqisë-paritetit) si përqindje e mesatares BE-15 në vitin përkatës. Të dhënat janë marrë nga FMN-ja. Grupet e vendeve janë 10 ekonomi tranzicioni në përaftrim me BE-në (grafiku 1), vendet e mbetura jashtë BE-së në Evropën qendrore (Shqipëria, Bosnja, Kroacia, ish republika jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia) në grafikun 2, ekonomitë e ish Bashkimit Sovjetik përfshirë Rusinë por pa shtetet e Baltikut (grafiku 3), dhe Rusia (grafiku 4). Shtyllat në çdo grafik janë për vitin e parë prej kur të dhënat janë në dispozicion, 2001 dhe 2008 respektivisht.

Procesi i konvergjencës filloi në nivele shumë të vështira dhe ka qenë heterogjen. Për anëtarët e ri të BE-së, BPV për kokë banori u rrit ngadalë por vazhdueshëm nga viti 1993 gjer në vitin 2008, duke arritur rreth 50 për qind të mesatares BE-15. Ekonomitë tjera të Evropës qendrore filluan nga baza më e ulët dhe mbyllën vakuomet më ngadalë. Rusia vuajti rëndë në vitet 90-ta me një recesion të thellë, por ka rikthyer gjendjen e vet dhe tani është rreth 40% e mesatares së BE-së, kryesisht për shkak të trendëve të favorshme në çmimet e resurseve. Sidoqoftë tranzicioni ishte më pak i suksesshëm në kuptim të konvergjencës në vendet tjera CIS, ku duke filluar nga një bazë shumë e ulët, gjendja u përkeqësua në mes të viteve 1994 dhe 2001, megjithëqë dallimi është zvogëluar shumë pak që atëherë. Dallimi i BPV-së i këtij grupi përkundrejt BE-së është më i madhi në regjion.


Në këtë kontekst kriza e kreditit ka gjasa që të ketë ndikim të ndryshëm në përkeqësimin e modelit nëpër grafikë. Prandaj për vendet që janë integruar në sistemet Evropiane të prodhimit dhe tregtisë, recesioni në

Grafiku 1. 10 shtetet e reja ne BE




Vërejtje: Boshti vertikal shënon nivelin e BPV-së për kokë banori si përqindje e mesatares së BE-15


Grafiku 2. Pjesa tjetër e Evropës qendrore



Grafiku 3. Ish Bashkimi Sovjetik (pa shtetet e Baltikut)



Grafiku 4. Rusia



Vërejtje: Boshti vertikal shënon nivelin e BPV-së për kokë banori si përqindje e mesatares së BE-15

Evropën perëndimore ka gjasa që të amplifikohet në afat të shkurtër për shkak të rolit të tyre relativisht të madh në furnizimin e inputeve për eksportet Evropiane, për shembull në sektorin e automjeteve. Kjo mund të jetë mënjeluar pjesërisht nga stimulimet e shtuara për të reduktuar koston duke transferuar prodhimin jashtë vendit. Borxhet e huaja dhe të sektorit publik janë gjithashtu të rëndësishme, pasi që këto do të kufizojnë përgjigjet politike ndaj krizës. Për shembull vendet që kanë deficite të mëdha strukturore në sektorin publik, siç është Hungaria, do të kufizohen në përgjigjen e tyre politike, kurse vendet që mbështeten shumë mbi bankat e tejtendosura të huaja, siç është Letonia, mund të vuajnë në mënyrë më të ashpër në krizën globale të kreditit. Prandaj Republika e Çekisë dhe Polonia mund të vlerësohen më mirë sesa Hungaria ose Estonia. Është interesante se këto dallime nuk janë ndërlidhur mirë me parakushtet e tranzicionit ose shpejtësinë ose llojet e ndryshueshme të reformës, por me qëndrimet e fundit të politikës makroekonomike. Sidoqoftë anëtarësimi në BE, mbështetja ndërkombëtare, dhe modernizimi i rëndësishëm institucional sugjeron se konvergjenca do të rifillojë, në disa raste pas një intervali kohor. Rritja Ruse ndërlidhet ngushtë me çmimet e resurseve, por niveli i lartë i rezervave jep një shkallë të konsiderueshme të lirisë politike dhe, sikurse në shumë vende të BE-së në tranzicion, konvergjenca gjithashtu nuk ka gjasa që të ngadalësojë për kohë të gjatë. Rreziqet kryesore janë për ekonomitë tjera Evropiane dhe të vendeve CIS që kanë treguar konvergjencë shumë të ngadalshme gjatë tronditjes. Disa nga to kanë mjedise të paqëndrueshme ekonomike dhe politike

Përfundimet

Për shumicën e ekonomive në tranzicion, procesi i tranzicionit, sikurse vet globalizimi, ka gjasa që të rifillojë pasi që të kalohet kjo krizë në ekonomitë e zhvilluara. Sidoqoftë përkohësisht, disa ekonomi në tranzicion ka gjasa që të vuajnë më shumë sesa ekonomitë e zhvilluara, që do të thotë se për disa vite procesi i konvergjencës mund të shkojë mbrapsht. Këto vende ka gjasa që të jenë ato të Ballkanit dhe ish Bashkimit Sovjetik, e jo shtetet e reja anëtare të BE-së ose Rusia. Sidoqoftë disa anëtarë të BE-së do të vuajnë më shumë sesa të tjerat varësisht nga gjendja e financave publike të tyre dhe borxhi ndërkombëtar. Tutje, varësisht në atë nëse kërcënimet për konvergjencë janë afatshkurtra ose afatgjata, ato mund të përfaqësojnë sfida serioze aktuale për strukturat relativisht të paqëndrueshme politike dhe institucionale në ato vende.

Edhe pse është tepër herët për të gjykuar, forcat fundamentale që ngasin globalizimin duket se nuk kanë ndryshuar nga ngjarjet e fundit. Bile bile, siç tregojnë diskutimet e samitit G20 të prillit në Londër, kur rifillon rritja, ka gjasa se rritja do të bëhet në formë më të rregullt. Kjo sugjeron se procesi i tranzicionit atëherë do të bëhet i rivendosur, natyrisht në ekonomitë më të avancuara dhe stabile, edhe pse ndoshta gjithashtu me shprehje më të madhe në orientimin ose rregullimin nga shteti.

Saul Estrin është profesor i menaxhmentit dhe shefi i departamentit të menaxhmentit në 'London School of Economics'. Ai dëshiron që të falënderojë Angela Lei për asistencë në hulumtime dhe Mario Nuti, Milica Uvalic dhe redaktorët për komentet e dobishme në draftin e mëhershëm..



Implikimet e krizës globale financiare për Evropën Lindore

Anders Åslund

Kriza aktuale financiare globale është më e keqja që ka parë bota që nga Depresioni i Madh, 1929-33. Ajo ka goditur Evropën Qendrore dhe Lindore më rëndë se çdo rajon tjetër të botës. Ajo parasheh rënie në BPV në këtë vit për rreth 4 për qind, dhe së paku Letonia dhe Ukraina kanë gjasa që të përballen me rënie dyshifrore.

Deri në vjeshtë 2008, vendet e Evropës Lindore kanë pasur një dekadë të mrekullueshme me normë të rritjes mesatare të tërë rajonit prej 7-8 për qind në vit në saje të tre faktorëve. Së pari, në vitet 1990-ta këto vende kishin pasur një tranzicion të suksesshëm në ekonomi të tregut, me liberalizim, privatizim dhe stabilizim financiar. Së dyti, ato kanë përfutur shumë nga kapitali njerëzor i pashfrytëzuar. Së treti, eksportet e tyre u rritën përmes integritimit ndërkombëtar dhe lulëzimit global.

Por mbinxehja ishte e dukshme që nga viti 2006, kur kolegu im në Institutin Peterson për Ekonomi Ndërkombëtare, Morris Goldstein, paralajmëroi se Evropa Lindore do të jetë pika qendrore e krizës financiare të ardhshme për shkak të deficitit të madh të llogarisë rrjedhëse, borxhit të madh të huaj, mospërputhjet e monedhës, dhe normat e keqradhitura të këmbimit.

Evropa Lindore bënte një gabim klasik të politikës. Shumë vende kanë kurse fikse të këmbimit, veçanërisht Estonia, Letonia, Lituania, Bjellorusia, Rusia, Ukraina dhe Bullgaria. Siguria e gënjeshtërt e kursit të këmbimit tërhoqi flukse të mëdha hyrëse të huave afatshkurtra nga bankat evropiane. Hyrjet monedhës shtuan furnizimin me para, dhe inflacioni u rrit me rritjen e furnizimit me para të gatshme nga viti 2006. Inflacioni ishte më i rëndi në Ukrainë, që kulmoi në 31 për qind në maj 2008.

Joshja për bankat ndërkombëtare ishte i pazezistueshëm. Ato mund t'i jepnin hua konsumatorëve në Ukrainë për 50 për qind në vit me kosto minimale të financimit. Por kjo ishte skemë e rrezikshme spekulative. Hyrjet nga këmbimi valutë i huaj përshpejtuan importet dhe ngritën deficitin e bilancit të pagesave. Inflacioni i lartë me kursin fikse të këmbimit nxori vendet jashtë tregut. Herët a vonë, ato do të detyrohen që të shkurtojnë shpenzimet përmes devalvimit ose me mjete tjera.

Në verë të vitit 2008, i gjithë rajoni ishte mbinxehur në masë. Çmimet e pronave të paluajtshme kishin dalë jashtë kontrollit, por kishte edhe pak premisa në dispozicion. Pagat e profesionistëve të rinj ishin të çuditshme, pasi që punëtorët e kualifikuar mezi gjendeshin. Por tregjet e aksioneve ishin rënduar tashmë, duke treguar se diçka ishte seriozisht gabim.

Më 15 shtator 2008, Lehman Brothers falimentoi, dhe tregjet financiare anembanë botës u ngrinë. Papritur, Evropa Lindore gjeti veten pa ose me pak financa ndërkombëtare.

Vendi	Lloji i programit të FMN-së			
	Mjeti për reduktim të varfërisë dhe rritje ¹	Lehtësimi i tronditjes Ekzogjene ²	Aranzhimet Rezervë ³	Linja për kredi fleksibile ⁴
Armenia			\$540 milion	
Bjellorusia			\$2.46 miliard	
Bosnja dhe Hercegovina			\$1.52 miliard ⁵	
Gjeorgjia			\$750 milion	
Hungaria			\$15.70 miliard	
Islanda			\$2.10 miliard	
Kirgiztani		\$100 milion		
Letonia			\$2.35 miliard	
Moldavia	\$118.20 milion			
Polonia				\$20.58 miliard
Rumania			\$17.10 miliard	
Serbia			\$4 miliard	
Taxhikistani	\$116 milion			
Ukraina			\$16.40 miliard	

1 Mjeti për reduktim të varfërisë dhe rritje është mjet nga FMN me kamatë të ulët për vendet me të ardhura të ulëta.

2 Mjeti për tronditje ekzogjene ofron mbështetje politike dhe asistencë financiare për vendet me të ardhura të ulëta të cilat përballen me tronditje ekzogjene

3 Aranzhimi rezervë është dizajnuar për të ndihmuar vendet që të adresojnë bilancin afatshkurtër të problemeve në pagesa

4 Linja për kredi fleksibile është për vendet me themele shumë të forta politike dhe që mbajnë regjistrat e zbatimit të politikave dhe është mjaft i dobishëm për qëllime të parandalimit të krizave

5 I nënshtrohet miratimit nga bordi i FMN-së

bëtare. Në fillim të tetorit, vendet e para, Ukraina dhe Hungari aplikuan për mbështetje të freskët financiare nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Tronditja globale e pashembullt e la FMN-në të përgjumur, por ajo shpejtë u zgjua dhe u dakordua për marrëveshjen e re rezervë për Ukrainën, Hungarinë dhe Letoninë. Shtetet tjera me marrëveshje të reja nga FMN-ja janë Gjeorgjia, Bjellorusia, Serbia dhe Rumania. Polonia ka përmbyllur marrëveshjen paraprake, kurse Turqia dhe Armenia janë afër marrëveshjeve të reja me FMN. Pritet se edhe disa shtete do të pasojnë.

Kriza financiare e Evropës lindore e vitit 2008-9 i përngjanë shumë krizës së Azisë lindore të vitit 1997-8. Problemi fundamental ishte dhe është hyrja e tepruar e kredive bankare afatshkurtra, të joshura nga shkalla e ulët këmbimore, që çon në borxhe të mëdha private të huaja. Financat publike në të kundërtën ishin në gjendje të shkëlqyeshme me përjashtim të Hungarisë dhe Rumanisë që kishin deficite të mëdha buxhetore por vetëm Hungaria kishte borxhe publike brengosëse.

Cenueshmëritë vendore u rënduan nga paniku më i keq financiar i të gjitha kohërave. Kapitali iku për në parajsat e perceptuara si të sigurta, dmth në ari, dollar, euro, yen dhe frang Zvicëran. Bile edhe Paundi Britanik dhe Krona Suedeze kishin peshë. Paniku financiar është dështim i tregut që duhet të shërohet nga shteti, dhe ndërkombëtarisht nga FMN-ja pritët që të ofrojë rrjedhë financiare kundërvepruese.

FMN ka vepruar shpejtë dhe mirë. Në krizën e Azisë lindore, FMN është perceptuar si tepër i bezdisshëm, duke shtuar shumë kërkesa për reforma strukturore në agjendën e vet tradicionale. Kësaj radhe FMN është kthyer në shërimin më themelor të Konsensusit të Uashingtonit nga vitet e hershme të 90-ave. Në thelb FMN-ja ka paraqitur tri kërkesa: buxhetin më afër bilancit, një politikë reale të shkallës këmbimore, dhe ristrukturim të bankës me rikapitalizim. Në anën tjetër për përmbylljen e këtyre kushteve, FMN ka ofruar hua shumë më të mëdha sesa më herët.

Me paraqitjen e krizës, u zhvillua bashkëpunimi i shkëlqyeshëm ad hoc në mes FMN-së dhe Komisionit Evropian (KE). FMN ka personel, rregulla dhe procedura për tu përballë me krizën financiare, përderisa KE nuk kishte dhënë e as asistuar. KE ka bashkë-financuar programet e FMN-së për Hungari dhe Letoni, dhe disa shtete Evropiane, përfshirë edhe Skandinavinë, dhe ka kontribuar me financim substancial në programin e Letonisë.

Edhe tri institucione tjera ndërkombëtare kanë luajtur rol substancial, do të thotë Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, dhe Banka Evropiane për In-

vestime. Përqendrimi i tyre kryesor ishte rikapitalizimi i bankës.

Një nga brengat më të mëdha ishte se bankat e Evropës Perëndimore që kishin blerë shumicën e bankave të Evropës Lindore do të tërhiqen nga regjioni. Gjer tani, asnjë bankë Evropiane nuk e ka bërë këtë, dhe shpresohet se kulmi i krizës ka kaluar. Në Ukrainë, 17 banka Evropiane me subsidiaritete në vend janë zotuar që të rikapitalizojnë subsidiaritetet e tyre Ukrainase me 2 miliarda \$ në vitin 2009.

Politika e normës këmbimore është bërë kurrizi i zënkës në programet e reja të stabilizimit. Është e qartë se politikat e normës këmbimore e kanë shkaktuar krizën por nuk do të thotë se doemos duhet të braktisen në mes të krizës. Nëse një shtet devalvon, bankat e saj mund të shtrydhen në të gjitha anët. Kostoja lokale e huave që bankat i kanë marrë nga jashtë do të ngritën shpejtë, dhe shumica nuk do t'i paguajnë me kohë. Klientët e tyre vendor që kanë marrë hua në monedhë të huaj gjithashtu nuk do të jenë në gjendje që ta kthejnë borxhin, me të ardhurat e tyre në monedhën e devaluuar.

Hungaria dhe Rumania kanë norma të ndryshueshme të këmbimit, që u zhytën së bashku me normat këmbimore të monedhave tjera që nuk përballeshin me krizën, siç janë Polonia dhe Republika e Çekisë. FMN detyroi Ukrainën për tu zhytur dhe Bjellorusinë që të devalvojë, por shtetet Baltike shfaqën pengesë. Ato për kohë të gjatë i kanë lidhur monedhat e tyre me euron, duke shpresuar për adoptimin e euros në fillim të vitit 2006 –shpresa që ishin hutuar nga normat në ngritje të inflacionit që u shfaqën gjatë vitit 2007-2008. Pasi që Letonia ende aspiron bashkimit me euro në vitin 2012, ajo kundërshton çdo devalvim.

Për një ekonomi të vogël të hapur që është tepër fleksibile, devalvimi vështirë se do të zgjidh ndonjë problem, përderisa sistemi bankar do të kolapsojë, duke shkaktuar shumë bankrotime dhe rrëtime. Qeveria e Letonisë, e mbështetur nga Skandinavët dhe KE, ofroi ndërmarrjen e 'devalvimit të brendshëm' duke shkurtuar rrogat dhe shpenzimet publike aq sa kërkohet. FMN pranoi me habi programin e rëndë të Letonisë si alternativë për devalvim. Edhe pse rezultatet ekonomike gjer tani janë përkeqësuar vazhdimisht më shumë sesa që është parashikuar, Letonia është duke shkurtuar aq sa kërkohet.

Për Evropën lindore, takimi i G-20 i 2 prillit ishte vital. FMN kishte vetëm 250 miliarda \$ fonde të cilat shumë lehtë mund të shpenzoheshin. Në Londër G-20 u dakordua që të katërfishohen fondet e FMN-së në mbi 1 trilion \$, duke i dhënë mjaft para për të mbajtur Evropën lindore jashtë nga çdo kurthi të likuiditetit. Si pasojë, tregjet të letrave me vlerë dhe bursat u përmirësuan në prill, bursa e shkatërruar Ukrainase ishte bursa që funksiononte më

së miri në botë duke raportuar ngritje prej 70% në muaj. Samiti i Londrës mund të shënojë fundin e krizës akute në Evropën Lindore, bile edhe nëse duhet të priten më shumë programe të FMN-së.

Shumë njerëz brengosen se kriza do të shkaktojë shqetësim shoqëror dhe bile ndërrim të regjimit, por gjer tani shqetësimi ishte shumë i kufizuar. Njerëzit duket se kuptojnë seriozitetin e krizës dhe kërkesat e fuqishme. Katër shtete në krizë kanë ndërruar qeveritë në gjysmë vitin e kaluar. Lituania dhe Rumania kishte zgjedhje parlamentare në fund të vitit të kaluar, dhe qeveritë e reja janë më përkrahëse të tregut të lirë sesa qeveritë paraprake. Në Letoni partia më liberale iu bashkua qeverisë së koalicionit qendër-djathtë dhe mori udhëheqjen për t'ï shpjeguar publikut pse kërkohet shkurtimi i pagave dhe i shpenzimeve. Në Hungari një kryeministër socialist u zëvendësua me një tjetër. Politika e Evropës lindore kryesisht i është përgjigjur si duhet krizës.

Pyetja e madhe është se si KE dhe Banka e Evropës Qendrore do t'ï adaptohen krizës. KE ka shtuar ndjeshëm bilancin e fondit të pagesave për shtetet anëtare nga 12 miliarda € në verën e kaluar në 50 miliarda €, dhe i ka dhënë kredi të mëdha Hungarisë, Letonisë dhe Rumanisë. Banka e Evropës Qendrore ende ka bërë shumë pak. Ajo duhet të përgatitet për ekspansion të eurozonës kah vendet më besnike – Estonia, Letonia, Lituania dhe Bullgaria si dhe Danimarka. Ajo gjithashtu duhet të zhvillojë letrat me vlerë dhe të zgjerojë diapazonin e mjeteve në dispozicion. Për eurozonë, kriza aktuale është mundësi e madhe që nuk duhet të huqet

Anders Åslund është zyrtar i lartë në Institutin Peterson për Ekonomi Ndërkombëtare. Së bashku me Andrew Kuchins, ai është bashkautor i librit 'The Russia Balance Sheet' (bilanci i Rusisë), (Uashington.: Instituti Peterson për Ekonomi Ndërkombëtare, 2009).



Përgjigja ndaj krizës: thelbi dhe periferia

Marek Dabrowski

Nga perspektiva në krizë

Në mileniumin e ri, ekonomia e botës, në veçanti pjesa e tregut në shfaqje e sipër, u përball me një periudhë të pashembullt të perspektivës, ku shumica e vendeve rriteshin në norma të larta ose shumë të larta pa marrë parasysh cilësinë e politikave të tyre ekonomike. Kjo tronditje globale mund t'i atribuohet pjesërisht reformave politike në një numër të vendeve dhe regjioneve të rëndësishme në dy dekadat e fundit, dhe përparim në liberalizimin e tregtisë globale (rezultatet e Raundit Uruguajas). Sidoqoftë ajo është stimuluar nga politikat shumë akomoduese monetare në Shtetet e Bashkuara dhe gjetiu të cilat i përgjigjeshin frikës nga recesioni dhe deflacioni duke shkurtuar drastikisht normat e interesit në vitin 2001-2002 dhe më pas duke i mbajtur në nivele rekorde të ulëta për kohë tepër të gjatë. Ngjashëm shumë ekonomi të tregut në shfaqje e sipër ndoqën politikat neo-merkantiliste duke mbajtur monedhat e tyre të nënvlerësuar dhe duke ndërtuar rezerva të mëdha për përkujdesje të këmbimeve të huaja, të cilat i shohin si siguri më i mirë përballë krizës monetare (mendim që ndahet nga Fondi Ndërkombëtar Monetar (FMN)).

Këto politika çuan në akumulimin e likuiditetit të tepërt në ekonominë e botës që në anën tjetër shkaktoi tejnxehjen globale dhe rritjen e sektorit së pronave të paluajtshme në Shtetet e Bashkuara dhe në disa vende Evropiane, sektorit të bursës, dhe sektorit të tregut të mallrave. Shpërthimi i këtyre sektorëve destabilizoi sektorin financiar në Shtetet e Bashkuara dhe në vendet tjera të zhvilluara. Sa i përket perspektivës që i parapriu atyre, kriza financiare dhe recesioni ka me të vërtetë karakter global. Sipas projeksionit të fundit të FMN-së, bruto produkti botëror mund të dallojë në vitin 2009 për herë të parë që nga vitet 1930-ta.

Kriza ka filluar në verën e vitit 2007, në thelb të ekonomisë botërore, në sistemin financiar të SHBA-ve. Ajo më pas u zhvendos në Evropën perëndimore dhe në Japoni, përfundimisht duke goditur periferinë (do të thotë vendet në zhvillim dhe tranzicion) në fund të vitit 2008. Falimentimi i Lehman Brothers në shtator 2008, një nga bankat më të mëdha investuese në SHBA, ishte pikë kthese, që thelloi krizën dhe përshpejtoi përhapjen në pjesët tjera të botës që nuk ishin prekur ende.

Përveç keqkalkulimeve të politikës monetare, edhe faktorët institucional, rregullator dhe mikroekonomik kanë kontribuar në shpërthim dhe në thellësinë e krizës. Mungesa e koordinimit të politikës ndërkombëtare makroekonomike (monetare) dhe mungesa e mbikëqyrjes mbi-kombëtare e tregjeve financiare shumë të integruara të botës ishin

ndoshta disa nga mospërputhjet më serioze sistematike. Gjithashtu, mbikëqyrja kombëtare financiare është shpesh herë shumë e dobët dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të ndjekur produktet e reja financiare. Ndarja e saj tradicionale sektoriale pamundësoi mbikëqyrjen financiare që të mbajnë ritmin me integrimin e shpejtë ndërsektorial të institucioneve financiare, siç ishte e dukshme në ndërtimin e konglomerateve të mëdha financiare, siç është AIG. Rregulloret e kujdesshme pro-ciklike (Bazel 2 ka një karakter pro-ciklik më të fortë sesa Bazel 1), metodologjitë e vlerësimit të rrezikut që nuk ishin në gjendje që të ndjekin risitë financiare, si dhe skemat e gabuara të stimulimit (p.sh., pagesat për menaxhim të bazuara në përfitime afatshkurtra, pagesat për agjencitë e rejtingut të paguara nga klientët) gjithashtu kontribuan në shtrembërimet e tregut, dhe përkeqësim të tronditjes dhe dështim të fazave të ciklit të biznesit.

Sa ekonomi të reja janë goditur nga kriza?


Drejtimi i shpërndarjes së kësaj krize (nga 'thelbi' për në 'periferi') dallon nga kriza e viteve 1997-1998 për tregjet e reja, që filloi në Azi, e pastaj u përhap në Rusi, Bashkësinë e Shteteve të Pavarura (CIS), dhe Brazil dhe në fund goditi disa institucione financiare në SHBA. Kriza e tanishme është më afër me atë të Depresionit të Madh të viteve 1930-ta ose kriza e dollarit amerikan në vitet 1970-ta. Prandaj ekonomitë në zhvillim ishin viktima relativisht të vona. Ato vazhduan që të rriten përgjatë pjesës më të madhe të vitit 2008 falë pjesërisht çmimeve të larta të mallrave, deri në rrëzimin e tyre në fund të verës së vitit 2008. Në fund, ato u goditën nga tkurrja në kërkesën globale dhe çmimet në rënie të mallrave, shtrydhjes globale të likuiditetit dhe rrjedhat dalëse si rezultat dhe shqetësim për rrezik të kapitalit, ndonjëherë nga problemet në institucionet burimore financiare në vendet e zhvilluara, paqëndrueshmëria në rritje e kursit të këmbimit (përfshirë edhe amortizimin konkurrues të partnerëve kryesore tregtar dhe konkurrentët), dhe rënies së kërkesës për punën e emigrantëve. Efektet e raundit të dytë mund të përfshijnë, ndër të tjera, problemet e sektorit bankar që rezultojnë nga paaftësia për të paguar nga ana e klientit, e shkaktuara nga recesioni dhe zhvlerësimi i kursit të këmbimit.

Përgjigjet politike: thelbi dhe periferia

Përgjigjet konkrete duhet të reflektojnë rrethanat kombëtare ekonomike dhe resurset në dispozicion. Sidoqoftë janë disa rekomandime të përgjithshme të cilat të gjitha shtetet duhet të provojnë t'i ndjekin. Pikë së pari ato duhet të shmangin masat proteksioniste dhe politikën 'lyp nga fqinjët' të cilat mund të thellojnë recesionin global (siç ndodhi në vitet e 30-ta). E dyta, ato duhet t'i rezistojnë joshjeve për të nacionalizuar dhe zgjeruar përherësisht sektorin publik që mund të çojë në rënie të produktivitetit, ngarkesa të tepruara fiskale, politizim të aktiviteteve të biznesit, korrupsion prandaj duhet të

shihet vetëm si zgjidhje e përkohshme dhe vetëm për bankat dhe institucionet tjera fiskale të rëndësishme sistematike, dhe vetëm atëherë kur opsionet tjera për shpëtim/rikapitalizim nuk janë në dispozicion. Në çdo rast, që nga fillimi duhet të parashihet një strategji e qartë dalëse.

Figura 1. Paratë e rezervës federale në miliona dollar amerikan



Burimi: <http://www.federalreserve.gov/datadownload/>.


Shumë vende duhet t'i kthehen në reformat strukturore dhe institucionale që ishin harruar gjatë kohës së prosperitetit, me qëllim të zbutjes së pasojave të krizës dhe rritjes së potencialit pas përfundimit të krizës. Pakot e tilla të reformave duhet të përshtaten për të adresuar kushtet specifike në çdo vend, por ato mund të përfshijnë fleksibilitet për punë dhe treg të produkteve, masat për të përmirësuar klimën e biznesit, luftimin e korrupsionit, privatizim të ndërmarrjeve të mbetura shtetërore, dhe racionalizim të politikave shoqërore. Mbikëqyrja financiare duhet të rishikohet detalisht në nivel kombëtar dhe mbi-kombëtar (brenda BE-së dhe globalisht). E njëjta mund të zbatohet për koordinimin global dhe regjional të politikave makroekonomike, dhe sjelljen e raundit të liberalizimit të tregut Doha në përfundim të suksesshëm. Vendimet e fundit të G-20 për të rikapitalizuar FMN-në dhe Bankën Botërore, për të zgjeruar mandatin e tyre dhe rebalancim të fuqive votuese në favor të vendeve në zhvillim, janë goxha shpresëdhënëse në këtë kuptim.

Sidoqoftë vendet që i përkasin 'thelbit' të ekonomisë botërore kanë role dhe resurse të ndryshme në zbatimin e politikave anti-krizë në krahasim me vendet në 'periferi'. Këto janë më të qarta në kuptim të monedhave, ku vetëm disa prej së cilave (siç është dollari amerikan, Euro, dhe në nivel më të ulët Yen i Japonez, Frangu Zvicëran dhe Paundi Britanik) shërbejnë si mjete globale të këmbimit, njësi të llogaritjes dhe depozitim të vlerës. Pas kolapsit të ndërmjetësitimit financiar (dhe reduktimit të shoqëruar në shumëzues të parave) pas falimentimit të Lehman Brothers, agjentët ekonomik ngritën kërkesën për para bazë, të lëshuara nga bankat më të mëdha qendrore. Përkundër tepricave politike paraprake, këto banka duhej të përmbushnin këtë kërkesë, siç është treguar në figurën 1 më poshtë. Pyetjet kyçe janë se sa larg duhet shkuar me këtë ekspansion monetar, si të tërhiqen stimulimet monetare kur rreziku i deflacionit hap rrugë për rrezik të inflacionit ose stagflacionit, dhe çfarë të bëhet me asetet e këqija të akumuluar nga disa banka qendrore (siç është Rezerva Federale e SHBA-ve) në drejtim të lehtësimit kuantitativ agresiv.

Ekonomitë e 'periferisë' përballen me sfida tjera: rënia e kërkesës për monedha reflektojnë dhe çojnë në dalje masive të kapitalit dhe zhvlerësim të normave këmbimore që mund të shkaktojnë falimentimet e ndërmarrjeve, konsumatorëve dhe bankave që janë në borxh në monedhë të huaj. Lehtësimi agresiv monetar për të ndihmuar sektorin e patundshmërive mund të përshpejtojë fluturimin nga monedha vendore dhe të përkeqësojë efektet e krizës.

Gjërat janë edhe më të komplikuar në rastin e politikës fiskale. Stimulimi global fiskal i propozuar nga FMN është joreal në kuptim të vendeve që dallojnë në pengesat për huamarrje, në veçanti në kohën e shqetësimit të tregut. Lehtësimet e tepruara fiskale në ekonomitë e 'periferisë' me hapësirë të kufizuar fiskale, mund të ngritë spektrin e mosplotësitimit të zotimeve. Por edhe kur ato vende që janë në pozitë më të mirë fillestare (me borxhe më të vogla pub-

Përqindja e popullsisë



Burimi: Kalkulimet e personelit të Bankës Botërore, ne bazë të Kombeve të Bashkuara 2005

like dhe të huaja, ose rezerva më të mëdha fiskale, siç është rasti me prodhuesit e naftës) dhe reputacion më të mirë të tregut, duhet të mendojnë më shumë para se të zgjedhin stimulimet agresive fiskale. Së pari shumë prej tyre do të përballen me sfida të mëdha fiskale që lidhen me popullsinë në plakje gjatë dekadave në vijim. E dyta, përderisa është politikisht lehtë të fillohet me stimulim fiskal, ndalimi ose tërheqja është shumë më e vështirë. E treta, pakot e stimulimit fiskal shpeshherë përfshinë rreziqet e proteksionizmit eksplicit ose implicit të tregut. Përfundimisht, stimulimi fiskal i shkallës së madhe mund të nënkuptojë grumbullimin e aktiviteteve ose kërkesave të sektorit privat për resurset që me të vërtetë kërkohen nga vendet në zhvillim.

Përkundër këtyre rreziqeve, ekonomitë 'në thelb' nuk kanë alternativë për të marrë përgjegjësinë fiskale për riparim të sistemit global financiar dhe për të ndihmuar ekonomitë 'periferike' për të rezistuar presionet shtypëse mbi monedhat e tyre. Pa riparim të sistemit global financiar, përfundimi me kohë i recesionit ka gjasa të vogla.

Rruga përpara: bota pas krizës

Cilësia e menaxhimit të krizës do të përcaktojë kohëzgjatjen dhe seriozitetin, si dhe perspektivat ekonomike

pas krizës. Përderisa askush nuk mund të parashikojë me saktësi kohëzgjatjen, thellësinë dhe pasojat e krizës, studimi i cikleve të biznesit tregojnë se do të përfundojë dikur, dhe ekonomia do të fillojë të rritet. Të shpresojmë se vendet më të mëdha do t'i shmangen joshjeve të proteksionizmit dhe se qeverisja globale ekonomike do të forcohet. Nëse ndodh ky skenar optimist, të arriturat kryesore të globalizimit gjatë tri dekadave të para duhet të mbetet i paprekur. Sidoqoftë ka gjasa të vogla që ekonomia botërore të rritet në ritmin e vërejtur më herët gjatë kësaj dekade. Politikat makroekonomike në ekonomitë më të mëdha duhet të jenë më pak akomoduese, dhe sektori financiar më pak i ndikuar dhe më rezistues nga rreziku. Në horizont nuk ka burime të mëdha të fitimeve nga produktiviteti. Është gjithashtu e qartë se ekonomitë 'në thelb' dhe ato 'periferike' do të përballen me pengesa më të fuqishme fiskale të cilat do të kërkojnë përshtatje serioze në politikën e shpenzimeve publike. Kthimi në reformat ekonomike dhe institucionale, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, mund të jetë rasti më i mirë për të rritur potencialin e rritjes globale.

Marek Dabrowski është President i CASE – Qendra për hulumtime sociale dhe ekonomike, Varshavë

Kontrolli i Qualitetit:

Mytaher Haskuka

Udhëheqës i Sektorit për Politika dhe Hulumtime

Behar Xharra

Ekspert për Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit

Produkcioni: **RROTA**

www.rrota.com

Përkthimi: **DAS Group**

www.dasgroup-ks.com

